




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRAN

Nr. / Br. 10212/23

Nr. i Sq. / Br. sh. _____

Data: / Datum: 02.03.2023

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRISË

DATË/A	02.03.2023
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetari të Komunës z. Ferit Idrizi <i>F. Idrizi</i>
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DEBPZHR-së z. Ergin Sungur <i>E. Sungur</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PER APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: " Subvencionimi i prodhimit të qumështit".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve – blegtorëve prodhues të qumështit, të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2023 do të subvencionojë prodhimtarinë e qumështit.

II. Mënyra e subvencionimit.

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese ose në fabrika të përpunimit të qumështit në vlerë prej 0.05€/litër;

- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.

III. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë.

- Të dorëzoj më shumë se 2000 litra qumësht për 6 muaj.

- Të posedoj kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznes dhe që kanë kontratë me ndonjë nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofrojë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

IV. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Vërtetimin nga pika grumbulluese ose qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Korrik- Dhjetor 2022;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV;
4. Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar)- pasqyra bankare;
5. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose pikat grumbulluese të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuar.

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: 02.03.2023 – 16.03.2023.

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.